



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEQA"

### Syllabusi i lëndës: Menaxhimi i Dëmeve

| Të dhëna bazike të lëndës |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Njësia akademike:         | Fakulteti i Biznesit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Titulli i lëndës:         | Menaxhimi i Dëmeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Niveli:                   | Master                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Status i lëndës:          | Obligative                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Viti i studimeve:         | I                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Numri i orëve në javë:    | 2+2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Vlera në kredi – ECTS:    | 6                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Koha / lokacioni:         | Semestri dimëror                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Mësimdhënësi i lëndës:    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Detajet kontaktuese:      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Përshkrimi i lëndës       | Lënda <b>Menaxhimi i Dëmeve</b> fokusohet në studimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mundshme dhe dëmeve që mund të ndodhin në një organizatë. Kjo lëndë përfshin identifikimin, vlerësimin, parandalimin dhe menaxhimin e riskut dhe dëmeve të mundshme të cilat mund të kenë ndikim negativ në aktivitetet e një kompanie apo organizate.                                                                                                                                                                                                                                               |
| Qëllimet e lëndës:        | <ul style="list-style-type: none"><li>• Qëllimi i lëndës është të pajisë studentët me njohuri themelore mbi Menaxhimin e dëmeve dhe riskut.</li><li>• Të trajtojë studentët për të njohur dhe kuptuar rrezikun, të identifikojnë zonat e rrezikut dhe të zhvillojnë strategji të menaxhimit për të zbutur apo parandaluar dëmet në përputhje me qëllimet dhe nevojat e ndërmarrjeve.</li><li>• Të aftësojë studentët për krijimin e planeve të menaxhimit të rrezikut, përdorimin e mjetet e analizës së rrezikut dhe zhvillimin e praktikave efikase të menaxhimit të dëmeve.</li></ul> |
| Rezultatet e pritura të   | Pas përfundimit të ligjëratave në këtë lëndë, studentët                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

|                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                  |                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|------------------|
| <b>nxënies:</b>                                                                                                  | duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të kuptojnë menaxhimin e dëmeve dhe riskut;</li><li>• Të jenë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në menaxhimin e riskut dhe dëmeve;</li><li>• Të krijojnë Aftësi për identifikimin dhe vlerësimin e dëmeve;</li><li>• Të jenë në gjendje për Zhvillimin e planeve të menaxhimit të rrezikut;</li></ul> |                  |                  |
|                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                  |                  |
| <b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                  |                  |
| <b>Aktiviteti</b>                                                                                                | <b>Orë</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>Ditë/javë</b> | <b>Gjithësej</b> |
| Ligjerata                                                                                                        | 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 15               | 30               |
| Ushtrime teorike/laboratorike                                                                                    | 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 15               | 30               |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet                                                                           | 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 10               | 10               |
| Punë praktike                                                                                                    | 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 15               | 15               |
| Teste, detyra të shtëpisë                                                                                        | 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 5                | 10               |
| Seminare, projekte kërkimore, prezentimet,etj.                                                                   | 10                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 1                | 10               |
| Koha e studimit vetanak të studentit                                                                             | 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 15               | 30               |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)                                                            | 10                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 1                | 10               |
| Përgaditja përfundimtare për provim                                                                              | 5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 1                | 5                |
| <b>Totali</b>                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                  | <b>150</b>       |
|                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                  |                  |
| <b>Metodologjia e mësimëdhënies:</b>                                                                             | Gjatë ligjërimit matëriali mësimor do të shpjegohët nga profësori i lëndës përmes prezantimit në PowerPoint. Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor. Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Gjatë                                                                 |                  |                  |

|                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                     | ligjërimin do të diskutohen edhe raste të studimit të cilat do të diskutohen në grup dhe do të analizohen edhe detyrat që u japën studentëve si punë grupore.                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Metodat e vlerësimit:</b>        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Testi i parë vlerësues: 0 - 40%</li> <li>• Testi i dytë vlerësues: 0 - 40%</li> <li>• Punimi shkencor: 0 - 20% ose</li> <li>• Provimi përfundimtar: 0 - 80%</li> </ul>                                                                                                                                                                |
| <b>Literatura</b>                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Literatura bazë:</b>             | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Sigurimi dhe Menaxhimi i Riskut</i>, Autori; John Teale, CCH AUSTRALIA LIMITED, 2013, ISBN 978-1-922042-88-0</li> </ul>                                                                                                                                                                                                            |
| <b>Literatura shtesë:</b>           | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Parimi i sigurimit</i>, Autorët; ROBERT I. MEHR dhe EMERSON CAMMACK, Edicioni i 7 Homewood, Illinois, 1980</li> <li>▪ <i>Principles of Risk Management and Insurance</i>, George E. Rejda, 10th Edition, Addison Wesley, Boston, 2008.</li> <li>▪ <i>Risk Management and Insurance</i>, Etti Baranoff, 2004, Wiley, USA</li> </ul> |
| <b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Java</b>                         | <b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Java e parë:</b>                 | Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Java e dytë:</b>                 | Natyra e rrezikut dhe menaxhimi i tij                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>Java e tretë:</b>                | Hyrje në menaxhimin e rrezikut.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Java e katërt:</b>               | Sigurimi dhe rreziku                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Java e pestë:</b>                | Rregullorja dhe pajtueshmëria                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Java e gjashtë:</b>              | Kontrolli rregullator i ndërmjetësve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Java e shtatë:</b>               | Konceptet në themel të ligjit të sigurimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Java e tetë:</b>                 | Testi i parë vlerësues                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Java e nëntë:</b>                | Hyrje në sigurimin e jetës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |

|                              |                                       |
|------------------------------|---------------------------------------|
| <b>Java e dhjetë</b>         | Hyrje në sigurimin e përgjithshëm     |
| <b>Java e njëmbëdhjetë:</b>  | Menaxhimi i rrezikut personal         |
| <b>Java e dymbëdhjetë :</b>  | Produktet e sigurimit të jetës        |
| <b>Java e trembëdhjetë:</b>  | Produktet e sigurimit të përgjithshëm |
| <b>Java e katërbëdhjetë:</b> | Sigurimi i mandatuar dhe shëndetësor  |
| <b>Java e pesëmbëdhjetë:</b> | Testi i dytë vlerësues                |

| <b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b><i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;</li> <li>• Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;</li> <li>• Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;</li> <li>• Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;</li> <li>• Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.</li> <li>• Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.</li> </ul> |